Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar  Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
<b>Firma</b>	
<b>Vula e Autoritetit Kontraktor</b>	

### Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

#### MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik:\_\_\_\_\_

**Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:\_\_\_\_\_**

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhëne në këtë tabelë.

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 11

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)*

### **DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS<sup>4</sup>**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Autoriteti kontraktor</b>	<b>Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës</b>	<b>Vlera e shpallur fituese</b>

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

<sup>4</sup> Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatorit ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## **Përfaqësuesi i ofertuesit**

### **Nënshkrimi**

### **Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

## **Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Kopje të çertifikuara (nga organet tatimore) të bilanceve të tre viteve të fundit 2017 - 2018 —2019
- b. Kopje e deklaratës se xhirove të 3 (tre) viteve 2017, 2018, 2019, e cila duhet te kete një xhiro mesatare jo më të vogel) se vlera prej 50% e fondit limit.

2.2 Kapaciteti teknik:

1. Përsa i përket eksperincës së mëparshme, Operatori Ekonomik duhet te permbush kerkesat e mëposhtme:

- a) - punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit,

Ose

b) - punë të ngjashme deri në një kufi, në vlera monetare totale e punëve të kryera, e marra së bashku, gjatë tri viteve të fundit është jo më pak se sa dyfishi i vlerës limit të kontratës, që prokurohet.

***Plotesimi i njërit prej 2 kushteve të sipërmendura e ben oferten te kualifikueshme.***

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim .

Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për përvojën e mëparshme me institucionet shtetërore (entete publike), për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve operatori ekonomik duhet të paraqesi :

- Formuluar Vlerësimi sipas shtojcës Nr. 9 e shoqëruar me :
- Kontratë sipërmarrje
- Situacioni përfundimtar
- **Aktin e Kolaudit**
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim

Për përvojën e mëparshme me sektorin privat për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve operatori ekonomik duhet të paraqesi :

- 4• Leje ndërtimi
- 4• Situacioni përfundimtar
- Aktin e Kolaudit
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/aktin e përdorimit

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari që ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim..*

2. Për sa i përket aftësive teknike e profesionale Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale :

Liçensa profesionale e shoqërisë, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore:

Referuar VKM — së Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar, Lidhja 3 “shpjegime për kategoritë e ndërtimeve(punime) të përgjithshme”



NP - 4 A (**Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvajl, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportual**).

*(Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të vecanta, tynellet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punimet të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të vecanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristika teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.*

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndëruar paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të vecantë.*

NP - 12 A (**Punime të inxhinierisë së mjedisit**)

*(Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të vecanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimet të kompaktësimet të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme*

*Perfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimet natyror, botanik (faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrit hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.)*

NS — 6 A (**Sinjalistika rrugore jodricuese**)

*(Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës*

*rrugore jodricuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.)*

NS — 18 A (Punime topogjeodezike)

*(Konsiderohet zbatimi i rivegjetizimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të vecantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike: rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.)*

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalencën e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinit, pranë institucioneve të autorizuar të Republikës së Shqipërisë.*

3. Operatori Ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 30) (**tridhjetë**) punonjës të siguruar për periudhën **Gusht 2020** — Dhjetor **2020** duke përfshirë dhe stafin teknik.

Kjo të dëshmohet me :

Vërtetimin nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/oss Tatimore

- List — pagesat sipas formës që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për të gjithë periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

4. Vetëdeklarim nga Operatori Ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/a të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo inë të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon kandidati sipas licensës profesionale të lëshuar nga autoriteti kompetent.

5. Stafi teknik i shoqërisë të ketë në përbërje (për stafin të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si, diplomat e inxhinierëve, dëshmi profesionale të punonjësve teknik, ose ekuivalenti i tij/saj):

- Inxhinier Ndërtimi	<b>1 (një)</b>
- Inxhinier	1 (një)
- Gjeodet/TopografMarkshajder	1 (një)
- Inxhinier Mjedisi	

I gjithë stafi teknik duhet të figurojë në list — pagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar, ndërsa përsa i përket inxhinierit të ndërtimit dhe atij Gjeodet/TopografMarkshajder duhet të figurojnë edhe në licencën e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

I gjithë stafi i kërkuar duhet të paraqesi dokumentacionin :

- Kontratë pune e vlefshme për periudhën e ekzekutimit të kontratës
- Diplomë

## **Librezë pune**

Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucionet ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit në fuqi

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek në bazë të ligjit Nr. 10 237, datë 18.02.2010 dhe VKM — së Nr. 108, datë 09.02.2011 për të cilin duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme **gjatë** gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, diplomë, dhe urdhër mjeku.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesi dokumentacionin se ka në stafin e tij specialistat simë poshtëm :

- 1 (një) Teknik Ndërtimi për të cilin duhet të paraqesi Diplomë/Dëftesë profesionale të shkollës së mesme, Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucionet ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit në fuqi, Kontratë pune e vlefshme gjatë ekzekutimit të kontratës si dhe dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- 3 (tre) **Manovratnrë** të cilët duhet të jenë të pajisur me Leje/Dëshmi të aftësisë profesionale të lëshuar nga Ministria e Transportit, Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucionet ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit në fuqi . Kontratë pune e vlefshme gjatë ekzekutimit të kontratës si dhe dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- 4 (**katër**) **Shofer** të cilët duhet të jenë të pajisur me Leje (leje drejtimi) të aftësisë profesionale të lëshuar nga Ministria e Transportit, Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucionet ekuivalente të akredituara sipas legjislacionit në fuqi. Kontratë pune e vlefshme gjatë ekzekutimit të kontratës si dhe dhe të figurojë në listpagesat eshoqërisë për periudhën e kërkuar.

- Operatori ekonomik duhet tii **ketë** minimalisht **10 (dhjetë) punonjët** të pajisur me Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHT1 pa përfshire ketu stafin teknik (specialista dhe inxhiniera)

8. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Analizë Çmimesh për të gjithë zërat në preventiv. Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument për zërat përkatës të marrë përsipër sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

9. Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

***Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:***

Mjetet	Sasia	Pronësia
Kamionçinë me kapacitet (mbajtës/ekspomies) 3.5 - 5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet (mbajtës/transportues) deri 12 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goina	1 copë	Pronësi ose me qem
Autobotuji	1 cop	Pronësi ose me qera
Rut me vibrim (për shtresat e çakëllit)	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul me kompresor (për asfaltobeton)	2 copë	Pronësi ose me qera
Greider	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Makineri për vijëzim me bojë bikomponente	1 copë	Pronësi ose me qera
	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punt U punëtortive/personelit si me poshtë :  
Kokore minimumi 20 (njtizedé) cop

Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 titra secila, minimumi 2 (dy) copë);

- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 3 (tre) copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt, minimumi 5 (pesë) copë.
- Prozhektorë ndriçimi natën, minimumi 4 (katër) copë)

Për të dëshmiar këtë, Formulari i shtojcës 10 të DST duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

- Për paisjet, nëse janë me qera, duhet të paraqiten kontratat e qirasë ku afati i marrjes me qera të mbulojë afatin e përfundimit të punimeve të objektit.
- Për mjetet që shënohen në regjistrim publike, nëse janë në pronësi, duhet paraqitur dokumenti që vërteton regjistrimin (leje **qarkullimi**), **taksën e regjistrimit, çertifikatën** e kontrollit teknik, policën e sigurimit vjetor dhe lejen e transportit lëshuar nga itomuna apo bashkia.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publike, nëse janë me qera, duhet të paraqitet dokumentacioni në emër të qeradhënësit që vërteton regjistrimin (leje **qarkullimi**), taksën e **regjistrimit, çertifikatën** e kontrollit teknik, **policën e sigurimit vjetor dhe lejen** e transportit lëshuar nga kooiina apo bashkia, si dhe kontrata e qirasë.

10. Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. Për këtë të paraqitet:

- Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera.  
» Deklaratë nga operatori ekonomik që autoriteti kontraktor gëzon të drejtën të bëjë kontrollin dhe verifikimin fizik të mjeteve dhe pajisjeve teknike në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, së bashku me adresën e saktë të vendodhjes së makinerive.
- Mos deklarimi i vendndodhjes së saktë të mjeteve të dhe angazhimi i tyre në kontrata të tjera në rast të verifikimit dhe dokumentimit nga **Autoriteti Kontraktor përbën kriter s'kualifikimi**.

11. Për të përmbushur kërkesat e STASH 660-87 dhe STASH 5fil-87, duke patur në konsideratë se përgatitja e asfaltit në fabrikë realizohet në temperaturë 155° C deri në 170 °C, operatori ekonomik duhet të disponojë fabrikë asfaltbetoni dhe/ose me qera dhe/ose të ketë kontratë furnizimi të vlefshme për periudhën e ekzekutimit të kontratës dhe sipas formës së kërkuar nga ligji minimalisht për sasinë e kërkuar në preventiv me një fabrikë asfaltbetoni me vendodhje jo më shumë se 25 km nga objekti që prokurohet, kjo për arsyen që tësigurohet ruajtja e temperaturës në ngjeshje të asfaltit jo më pak se 140° C. Fabrika e kërkuar duhet të jetë e pajisur me dokumentacionin e pronësisë, leje mjedisore të lëshuar nga QKL Kodi III. 1. B, e pajisur me çertifikatë ISO 9001:2015 "Mbi çertifikimin e cilësisë së asfaltit nga prodhuesi" (dhe në rastet e marrjes me qera apo kontrata të tjera sipas formës së kërkuar nga ligji të paraqitet dokumentacioni i mësipërnj)

12. Operatori, duhet të ketë :

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Certifikatën **SH EN ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente me të lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit për secilën shoqëri në raste bashkimi të operatorëve ekonomikë.
- Certifikatën **S SH EN ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” ose ekuivalente me to lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit për secilën shoqëri në raste bashkimi të operatorëve ekonomikë.
- Certifikatën **OHSAS 18001-2007/ 2013NOSE ISO 45001-2018** mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë” ose ekuivalente me to lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit për secilën shoqëri në raste bashkimi të operatorëve ekonomikë.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**



**Shtojca 15**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**Shtojca 16**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor* ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [ *Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues* ]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ *Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës* ]

Publikime të mëparshme ( *nëse zbatohet* ): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 17**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomike më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS** **Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

## Dokumenta Standarde të Tenderit

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore

ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.



- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

**Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 17: Zbulimet**

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

**Neni 18: Disponimi i Kantierit**

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

**Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteve.

**Neni 20: Paralajmërimi në Kohë**

